



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 257/24Prot.

Tiranë, më, 02.11.2017

V E N D I M

Nr. 154, Datë 02.11.2017

PËR
AUDITIMIN NË TË NXEHTË (TEMATIK)
MBI ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK
DHE ANKESAT E QYTETAREVE USHTRUAR
NË BASHKINË ROSKOVEC.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përfundim të auditimit të ushtruar në Bashkinë Roskovec, në zbatim të programit të auditimit nr. 257/1, datë 16.03.2017 (evaduar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 77, datë 30.06.2017) ka përcjellë në Bashkinë Roskovec dhe në Agjensinë e Prokurimit Publik (me shkresat nr. 257/14, datë 10.07.2017 dhe nr. 257/15, datë 10.07.2017) Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe Vendimin nr. 77, datë 30.06.2017 të Kryetarit të KLSH-së në lidhje me rekomandimet dhe masat përkatëse.

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, nga Kryetari i KLSH-së u vendos kryerja e një auditimi në të nxehtë (tematik) ndaj dosjes së auditimit të ushtruar në Bashkinë Roskovec në zbatim të programit të auditimit nr. 257/1, datë 16.03.2017.

Sa më sipër, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimi në të nxehtë (tematik) mbi zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe ankesat e qytetareve ushtruar në Bashkinë Roskovec".
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Roskovec, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), gjatë viteve 2015-2016 dhe 2017 nuk kanë kryer auditime në ish-Komunat duke përfshirë edhe ish-Komunën Kuman (aktualisht Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë), në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik“. Kryerja e auditimeve është e domosdoshme për shkak të riskut të lartë për këto zona me burime natyrore dhe me efekt në të ardhura, të cilat nuk janë audituar dhe nuk janë bërë transparente. Një situatë e tillë ka sjellë adresimin e ankesave nga një grup qytetarësh, banorë të ish-Komunave, përfaqësuar nga qytetari z. N D, administruar në KLSH me nr. 461, prot. datë 26.04.2017 dhe nr.753/1 prot. datë 14.08.2017.

(Trajtuar më hollësisht në fq. 7 – 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim:

Në kushtet e pamundësisë objektive të KLSH-së për të verifikuar rast pas rasti të gjithë dokumentacionin e ish-Komunave dhe Bashkisë Roskovec, si dhe pamundësisë ligjore (mungesa e kompetencës juridiksionale të KLSH-së për të audituar fonde jopublike) për të audituar të gjitha fondet apo donacionet e dhëna këtyre institucioneve nga subjekte të ndryshme, mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; sipas të cilit “KLSH ka të drejtë të propozojë njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencave të tyre”; nenit 25 “Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, rekomandojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Roskovec, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të marrë masa të kryejë auditim në ish-Komunën Kuman (aktualisht Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë Roskovec), ku të përfshijë verifikimin e problematikës së ankesave të qytetarëve përfshirë edhe ankesat e z. N D si dhe të informojë e japë përgjigje qytetarëve ankues duke informuar edhe KLSH-në.

Brenda datës 15 Dhjetor 2017

B-I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga ana e anëtarëve të Komisioneve për përllogaritjen e vlerës së fondit limit janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar në ligj vlerat e fondeve limite në procedurat e prokurimit, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, dhe VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, respektivisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Rikonstruktion rrugësh në qytetin Roskovec, rikonstruktion i rrugës Refat Cepele dhe rruga e lagjes Nr. 1, Loti I*”, vlera e fondit limit është rritur me 759,025 lekë pa TVSH.
- Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Ndërtim rrethrotullimi në anën lindore në unazën e Roskovecit*”, vlera e fondit limit është rritur me 754,490 lekë pa TVSH.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Jagodinë, Bashkia Roskovec”, vlera e fondit limit është rritur me 148,573 lekë pa TVSH.

Në total, për të treja procedurat e prokurimit, vlera e shtuar e fondit limit arrin në 1,662,088 lekë pa TVSH.

Nga të treja shtesat e sipërcituara të bëra në fondet limite të procedurave të prokurimit, e vetmja shtesë që ka shkaktuar dëm ekonomik është shtesa e fondit limit që është bërë në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim rrethrotullimi në anën lindore në unazën e Roskovecit” për arsye se kontrata (e datës 16.09.2016) e lidhur me subjektin fitues “B B dhe Sh”, me vlerë kontrate 7,396,955 lekë pa TVSH është 621,197 lekë pa TVSH mbi fondin limit ligjor prej 6,775,758 lekë pa TVSH. (7,396,955 - 6,775,758 = 621,197 lekë pa TVSH)

Vlera prej 621,197 lekë pa TVSH konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Roskovec.

(Trajtuar më hollësisht në fq. 7 – 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 shkronja (b), ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga Titullari i njësisë publike të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit ekonomik prej 621,197 lekë pa TVSH të rezultuar nga shtesa e paargumentuar dhe ligjore e fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim rrethrotullimi në anën lindore në unazën e Roskovecit”, ndaj tre anëtarëve të Komisionit për përllogaritjen e vlerës së fondit limit, të cilët kanë vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”; dhe VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, respektivisht **për 3 personat si më poshtë:**

- 1) z. E T, në vlerën **207,065 lekë pa TVSH.**
- 2) znj. D G, në vlerën **207,065 lekë pa TVSH.**
- 3) znj. B M, në vlerën **207,065 lekë pa TVSH.**

Menjëherë

B-II. KRYERJA E SHPENZIMEVE JO TË LIGJSHME DHE PËRDORIMI JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I FONDEVE PËR INVESTIME PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi:

- a) Nga ana e anëtarëve të Komisioneve për përllogaritjen e vlerës së fondit limit janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar në ligj vlerat e fondeve limite në procedurat e prokurimit dhe më konkretisht:
 - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në qytetin Roskovec, rikonstruksion i rrugës Refat Cepele dhe rruga e lagjes Nr. 1, Loti I”, vlera e fondit limit është rritur me 759,025 lekë pa TVSH.
 - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim rrethrotullimi në anën lindore në unazën e Roskovecit”, vlera e fondit limit është rritur me 754,490 lekë pa TVSH.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Jagodinë, Bashkia Roskovec”, vlera e fondit limit është rritur me 148,573 lekë pa TVSH.
Në total, për të treja procedurat e prokurimit, vlera e shtuar e fondit limit arrin në 1,662,088 lekë pa TVSH.
- b) **Nga ana e anëtarëve të Njësive të Prokurimit** janë hartuar kriteret kualifikuese të paargumentuara të cilat mund të konsiderohen edhe si diskriminuese dhe që kufizojnë pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit.
- c) **Nga ana e anëtarëve të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave** nuk është bërë një vlerësim i drejtë i ofertave ekonomike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit duke çuar kështu në kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik dhe më konkretisht:
 - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në qytetin Roskovec, rikonstruksion i rrugës Refat Çepele dhe rruga e lagjes Nr. 1, Loti I”, është kualifikuar dhe shpallur si fitues në mënyrë të padrejtë OE “Sh ” shpk. me vlerë kontrate 16,009,095 lekë pa TVSH.
 - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim rrethrotullimi në anën lindore në unazën e Roskovecit”, është kualifikuar dhe shpallur si fitues në mënyrë të padrejtë BOE “B B dhe Sh”, me vlerë kontrate 7,396,955 lekë pa TVSH.
 - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari i rrugës së fshatit Jagodinë, Bashkia Roskovec”, është kualifikuar dhe shpallur si fitues në mënyrë të padrejtë OE “A dhe E CO” shpk, me vlerë kontrate 5,200,000 lekë pa TVSH.

Në total, vlera e të treja kontratave prej 28,606,050 lekë pa TVSH nuk mund të konsiderohet si dëm ekonomik (si pasojë e faktit që ofertat e OE fitues nuk mund të krahasohen me ndonjë OE tjetër që i plotësonte kriteret për kualifikim) por **konsiderohet si një shpenzim jo i ligjshëm** i kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fushën e prokurimeve i dhënë në favor të operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësonin kriteret ligjore për tu kualifikuar dhe shpallur fitues **dhe njëkohësisht si një përdorim jo me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet i fondeve për investime publike.**

(Trajtuar më hollësisht në fq. 7 – 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim:

Mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; *sipas të cilit* “KLSH ka të drejtë të propozojë njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencave të tyre”; nenit 25 “Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Roskovec, të merren masa për kryerjen e një misioni auditimi mbi rregullshmërinë e procedurave të prokurimit me fonde publike të zhvilluara nga 01.01.2013 deri në 31.12.2017, duke treguar një kujdes të veçantë përlllogaritjeve të fondeve limite, vendosjes së kriterëve kualifikuese si dhe kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Rezultatet e këtij auditimi si dhe rekomandimet dhe masat e marra në lidhje me këtë auditim ti bëhen me dije Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Duke filluar nga muaji Nëntor 2017 e në vazhdim

C. MASA DISPLINORE:

Në kushtet kur për punonjësit e Bashkisë Roskovec të konstatuar si përgjegjës në lidhje me shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë rekomanduar paraprakisht masa disiplinore, sipas Vendimit nr. 77, datë 30.06.2017 të Kryetarit të KLSH (përcjellë Bashkisë Roskovec me shkresën nr. 257/14, datë 10.07.2017 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik me shkresën nr. 257/15, datë 10.07.2017), nuk përsërisim sërish të njëjtat rekomandime për personat si më poshtë:

1. **z. E T**, me detyrë specialist urbanistike dhe topograf në Bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Përlllogaritjes së vlerës së fondit limit.
2. **znj. D G**, me detyrë ekonomiste në Bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Përlllogaritjes së vlerës së fondit limit.
3. **znj. B M**, me detyrë juriste në Drejtorinë Juridike të Bashkisë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Përlllogaritjes së vlerës së fondit limit.
4. **znj. E M**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike në Bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
5. **znj. M C**, me detyrë specialiste finance në Bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
6. **z. E K**, specialist, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
7. **z. S C** me detyrë Drejtor Ekonomik në Bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
8. **z. A D**, me detyrë Drejtor i Shërbimeve në Bashkinë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Ndërsa për 3 punonjësit e mëposhtëm të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune me Bashkinë Roskovec masa disiplinore “largim nga puna” konsiderohet e ezauruar.

9. **z. F P**, ish-punonjës i Bashkisë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.
10. **z. R G**, ish-punonjës i Bashkisë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
11. **znj. E T**, ish-punonjës i Bashkisë Roskovec, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

D. PËRCJELLJE E RAPORTIT NË PROKURORI:

Në kushtet kur në lidhje me shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Bashkinë Roskovec (në zbatim të Programit të mëparshëm të Auditimit nr. 257/1, datë 16.03.2017) është përcjellë tashmë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, kallëzimi penal nr. 257/16, datë 20.07.2017 ndaj shtatë punonjësve dhe ish-punonjësve të Bashkisë Roskovec (respektivisht: **Znj. E T**, **Z. F P**, **Znj. E M**, **Znj. M C**, **Z. E K**, **Z. S C** dhe **Z. A D** KLSH nuk do të përcjellë sërish organit të Prokurorisë kallëzim penal ndaj këtyre personave por do të përcjellë për dijeni e vlerësim Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe Vendimin e Kryetarit të KLSH-së në lidhje me të.

E. TË TJERA:

Për ankesat e paraqitura dhe administruar në KLSH me nr. 461, prot. datë 26.04.2017 dhe nr.753/1 prot. datë 14.08.2017, ti kthehet përgjigje edhe qytetarit **z.N D**.

Menjëherë

F. GJETJE AUDITIMI JASHTË PROGRAMIT FILLESTAR TË

AUDITIMIT:

Gjatë auditimit në Bashkinë Roskovec, grupi i auditimit të KLSH-së, u zgjerua gabimisht në auditim (përtej programit të auditimit në të nxehtë) edhe në auditimin e zbatimit të kontratave të sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes (përsa i përket shtyrjeve të afateve të këtyre kontratave për objektet e mbetura ende në proces).

Pavarësisht faktit që nga kontrolli i cilësisë së kësaj dosje auditimi gjetjet e grupit të auditimit në drejtim të zbatimit të kontratave të sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes u cilësuan si të drejta, dalja jashtë programit të auditimit konsiderohet si një shkelje e e standardeve ndërkombëtare të auditimit njëherazi dhe standardeve të auditimit të KLSH-së.

Për rrjedhojë, KLSH rekomandon njëherazi analizimin dhe ndjekjen e mëtejshme dhe më të detajuar të këtyre gjetjeve nga struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Roskovec.

(Trajtuar më hollësisht në fq. 59 – 67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë projektvendim ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, si dhe Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

K R Y E T A R

Bujar LESKAJ